



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Nr. 185/6 Prot.

Tiranë, më 12.07.2022

**VENDIM**

**Nr. 93, datë 12.07.2022**

**PËR**

**PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË  
VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 29, DATË 22.02.2022**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit të Zbatimit të Vendimeve Paralajmëruese, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 29, datë 22.02.2022, të Komisionerit, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin Autoriteti i Mediave Audiovizive dhe përfundimin e procesit të mbikëqyrjes”.

**KONSTATOVA SE:**

Në zbatim të planit vjetor të mbikëqyrjes dhe në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, me qëllim mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit në administrimin e shërbimit civil, në institucionet që përfshihen në këtë fushë, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme në institucionin Autoriteti i Mediave Audiovizive. me vendimin nr. 66 (660 Prot.), datë 08.06.2021, “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil nëpërmjet pranimi në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, në institucionin Autoriteti i Mediave Audiovizive”.

Ky proces është përmbyllur me vendimin paralajmërues nr. 29, datë 22.02.2022, të Komisionerit, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin Autoriteti i Mediave Audiovizive dhe përfundimin e procesit të mbikëqyrjes”.

Me kalimin e afatit të lënë në Vendimin e mësipërm, institucioni, me shkresën nr. 891/2 prot., datë 02.06.2022, ka njoftuar Komisionerin mbi masat e marra në zbatim të këtij vendimi dhe me e-mailin e datës 23.06.2022, regjistruar pranë Komisionerit me nr. 185/4 prot., datë

24.06.2022, nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të këtij institucioni janë dërguar aktet që provojnë zbatimin e detyrave të lëna.

Mbështetur në gjetjet e specifikuar në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, si dhe në detyrat e lëna për Autoritetin e Mediave Audiovizive, në përmbajtjen e vendimit paralajmërues për rregullimin e ligjshmërisë, si dhe duke verifikuar veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse, të materializuara në dokumentet shkresore përkatëse, situata e administrimit të shërbimit civil në institucionin e mbikëqyrur paraqitet si më poshtë vijon:

Konkretisht, Komisioneri, në pikat 1 dhe 2 të dispozitivit të vendimit objekt i mbikëqyrjes në vazhdim, ka kërkuar respektivisht nga institucioni të anulojë aktet e nxjerra në kundërshtim me ligjin për emërimin dhe konfirmimin si nëpunës civil të punonjësit Gerhard Merja, si dhe të marrë masat për të rikthyer punonjësit \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\* në pozicionet ku ata gëzojnë statusin e nëpunësit civil, për shkak të mosplotësimit të një prej kushteve minimale të pranimit gjatë dorëzimit të dokumentacionit për procedurat e ngritjes në detyrë, që është vlerësimi i fundit “Mirë” apo “Shumë mirë”.

Konstatoj se, me urdhrin nr. 144, datë 01.06.2022, Autoriteti i Mediave Audiovizive ka urdhëruar anulimin e aktit nr. 247, datë 20.09.2019, të Sekretarit të Përgjithshëm për emërimin në shërbimin civil, në periudhë prove njëvjeçare të punonjësit Gerhard Merja, aktit nr. 837, datë 17.02.2021, të eprorit direkt për konfirmimin si nëpunës civil, si dhe aktit nr. 62, datë 18.02.2021, të Sekretarit të Përgjithshëm, për transferimin e përhershëm të këtij punonjësi në pozicionin “Specialist” në Sektorin e Çështjeve Juridike, në Drejtorinë Juridike dhe Licencave. Njëkohësisht, në pikën 2 të aktit në fjalë është urdhëruar përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil të \*\*\*\*\*.

Konstatoj gjithashtu se, në zbatim të pikës 2 të vendimit paralajmërues të Komisionerit, Autoriteti i Mediave Audiovizive, përkatësisht me urdhrat nr. 145 dhe nr. 146, datë 01.06.2022, ka urdhëruar anulimin e akteve:

- nr. 192, datë 11.07.2019, “Për lirimimin e \*\*\*\*\* nga pozicioni Specialist i Sektorit të Inspektiveve dhe emërimin në pozicionin Përgjegjës në Sektorin e Inspektiveve në Drejtorinë e Mbikëqyrjes” dhe
- nr. 155, datë 23.05.2019, “Për lirimimin e \*\*\*\*\* nga pozicioni Përgjegjës i Sektorit të Inspektiveve dhe emërimin në pozicionin Drejtor në Drejtorinë e Mbikëqyrjes”,

si dhe rikthimin në pozicionet e mëparshme të punës.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

## **VENDOSA:**

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 29, datë 22.02.2022, të Komisionerit, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin Autoriteti i Mediave Audiovizive dhe përfundimin e procesit të mbikëqyrjes”*.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit Autoriteti i Mediave Audiovizive, duke zbatuar rekomandimet e Vendimit Nr. 29, datë 22.02.2022.
3. Për këtë vendim të njoftohet Autoriteti i Mediave Audiovizive.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**